

VENDIM
Nr.1238, datë 16.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 4.2.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË
NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT
PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.78, datë 4.2.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Pagesa shtesë, që përfitohet sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet nga shërbimet bankare, që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar, ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha